



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 54 datë 25 09 2020

“Për dhënien e miratimit për zbatimin e programit social të strehimit (Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri), Udhëzuesin operacional për zbatimin e këtij programi, dhe formatin TIP të Aplikimit”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social”; VKM nr 384 datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKM nr 454, datë 03.07.2019 “ Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë ,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Miratimin e zbatimit të programit social të strehimit “ Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”
2. Miratimin e Udhëzuesit operacional për zbatimin e këtij program.
3. Miratimin e formatit TIP të aplikimit
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

ZV/KRYETAR

Ervis Shimoj

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Adriana Qelepejo

Miratuar me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.10.2020



SHTOJCA "A"

KËRKESA PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL

KËRKESË

PËR T'U TRAJTUAR ME STREHIM, BAZUAR NË LIGJIN NR. 22/2018, "PËR STREHIMIN SOCIAL"

FAZA E PARË E APLIKIMIT

Mbiemriemridatëlindja.....
 Qyteti Njësia administrative Rruga.....
 Pall. Shk. Ap. (Në rastin e një banese private) Nr..... Tel.....

I. GJENDJA FAMILJARE

MBIEMRI	EMRI	DATA LINDJA Dita/Muaji/Viti (00/00/0000)	(1) SEKSI	(2) GJENDJA CIVILE	Nr. DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT	(3) FAMILJARËT	(4) PUNËSIMI

Në tabelë hidhen kodet, si më poshtë vijon:

<u>1. SEKSI</u>	<u>2. GJENDJA CIVILE</u>	<u>3. FAMILJARËT</u>	<u>4. PUNËSIMI</u>	
Mashkull (M)	Beqar/e	1 Aplikanti	0 Punësuar në shtet	01
Femër (F)	i/e martuar	2 Nëna/Babai	1 Punësuar në privat	02
Nuk	i/e ve	3 Bashkëshorti/ja	2 I/E vetëpunësuar	03
Përgjigjem (N)	i/e divorcuar	4 I biri/E bija	4 Punësim i rastit	04
		Gjysh/e	5 I përfshirë në programin e ndihmës ekonomike	05
		Nip/Mbesë	6 I përfshirë në programin e pagesës së papunësisë	06
		Vjehri/a	7 Të tjerë	07
		Dhëndri/nusja	8	
		Vëllai/motra	9	
		Kunati/a	10	
		Të tjerë	11	

Shënim: Në kolonat 1, 2, 3 e 4 vendos numrin që i korrespondon gjendjes suaj. Të dhënat e kolonës 3 duhet të korrespondojnë me certifikatën familjare.

II. KUSHTET E STREHIMIT

POJ(C)

2. Disponon banesë në pronësi.....

2.1. Nëse **PO**, jep informacionin e saktë për:

- Prona është e regjistruar në emër të (vendos referencën sipas kolonës 3, të tabelës “Gjendja familjare”) _____

- Prona ka një strukturë:

- garsoniere

- struktura e apartamentit 1+1

- struktura e apartamentit 2+1.....

- struktura e apartamentit 3+1.....

- Sipërfaqja totale e banesës sipas dokumentit të pronësisë

- Sipërfaqja totale e banimit.....

2.2. Nëse jeni përgjigjur negativisht në pikën 2, vazhdoni me plotësimin e informacionit, si më poshtë vijon:

- Banoj me qira

- Banoj me prindërit

- Banoj në banesë informale

2.3 Banoj në banesë rrezik shembjeje

2.4 Banoj në banesë të mbipopulluar

2.5 Kam mbetur i pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore

Në sipërfaqen totale të banimit përfshihen sipërfaqja e dhomave të gjumit plus sipërfaqen e dhomës së ditës, të matura brenda mureve ndarëse.

2.6 Kam mbetur i pastrehë nga procese gjyqësore

.....

2.7 Banoj në banesë që prishet/përrjashtohet nga legalizimi

.....

III. KUSHTET FAMILJARE

Shëno vetëm në një kuti që i përshatet kushtit tuaj familjar

3.1 Familje një prindërore që kam në ngarkim fëmijë

3.2 I/E moshuar që kam mbushur moshën e pensionit dhe nuk jam përzgjedhur për t'u
strehuar në një institucion publik të përkujdesjes shoqërore.....

3.3 Familje me më shumë se 4 fëmijë

3.4 Çift me moshë jo më të madhe se 60 vjeç

IV. KUSHTET SOCIALE

Shëno në kutitë që u përshatën kushteve tuaja sociale

4.1 Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuara.....

4.2 Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç

4.3 Ka mbetur i pastrehë për shkak të lirimit të banesës ish-pronarëve

4.4 Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant

4.5. Azilkërkues

4.6 Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë

4.7 Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH)

4.8 Punonjës i RENEAs

4.9 Punonjës i Shpëtimit dhe i Mbrojtjes nga Zjarri

4.10 Viktimë e dhunës në familje

4.11 Viktimë e trafikimit

4.12 Anëtar i minoritetit rom

4.13 Anëtar i minoritetit egjiptian

4.14 I mitur në konflikt me ligjin

4.15 Vajza-nëna

4.16 Komuniteti LGBTI

4.17 Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike

V. TË ARDHURAT E FAMILJES

Ky seksion duhet të plotësohet për çdo person që siguron një të ardhur në familje, në përputhje me kolonat 3 e 4, të tabelës "Gjendja familjare". Në të ardhurat totale të familjes përfshihen të ardhurat neto nga punësimi, dypunësimi, pagesa e papunësisë, pagesa e ndihmës ekonomike, pensioni, dërgesa nga emigracioni, qira nga prona, transferita të tjera nga të afërmit, si dhe çdo lloj e ardhure tjetër që sigurohet mbi bazën mujore ose vjetore nga trashëgimi, interesa bankarë etj. Me të ardhura neto kuptohen të ardhurat pas shlyerjes së detyrimeve, si: taksa, tatime e sigurime shoqërore.

Të ardhurat totale mujore të familjes

Të dhëna të detajuara të të ardhurave mujore të familjarëve, sipas kolonës 3, të tabelës "Gjendja familjare"

00 04 08

01 05 09

02 06 10

03 07 11

Të ardhura nga emigracioni (vjetore)

Të ardhura nga qiraja (mujore)

Të ardhura të tjera (vjetore)

VI. FORMA E TRAJTIMIT SIPAS NJËRIT PREJ PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT²

Unë dhe familja ime kërkojmë të trajtohem me strehim nëpërmjet programit të:

(Rendit nga 1 deri në 4, sipas preferencës: 1 për preferencën më të madhe; 4 për atë më të ulët)

- Banesë sociale me qira

- Përmirësimi i banesës

- Banesë me kosto të ulët

- Tokë e pajisur me infrastrukturë për të ndërtuar vetë banesë

Shënim: Forma e përfutimit mund të ndryshojë nga ajo që ju keni cilësuar si më të preferuarën, në varësi të mundësive të zgjidhjes dhe aftësisë financiare të familjes suaj për të përballuar kostot.

² Banesat e përkohshme dhe banesa e specializuar, si rregull, propozohen nga bashkia, për rastet e veçanta, dhe nuk ofrohen si alternativa.

Në mungesë të banesave sociale me qira dhe në mungesë të banesave me kosto të ulët, njësi e vetëqeverisjes vendore ofron një nga instrumentet e mëposhtme financiare. Nëse ju pranoi, duhet të shënoni:

	Pranoj	Nuk pranoj
Në mungesë të banesave sociale, ofrohet subvencionimi i qirasë në tregun e lirë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Në mungesë të banesave me kosto të ulët, ofrohet, sipas mundësive buxhetore, subvencionimi i interesave të kredive....	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

UDHËZUES-OPERACIONAL

PËR

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË
STREHIMIT**

**“PROGRAMI PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË BANESAVE
EKZISTUESE, DERI NË NJË NDËRTIM TË RI”**

Datë ____ / ____ 2020

1. Hyrje

Bashkia Vau Dejës duke konsideruar numrin e lartë të banesave që janë nën normën e strehimit, hartoi një program specifik, për këtë qëllim.

Në kuadër të qëllimeve të Qeverisë për krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, në zbatim të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”

Nga programi për “përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”, përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm. Përparësi në trajtimin me këtë program sipas ligjit kanë:

- a) personat me aftësi të kufizuara;
- b) individët me statusin e jetimit;
- c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- ç) të moshuarit;
- d) komuniteti rom;
- dh) komuniteti egjiptian;
- e) komunitetet e zonave rurale;
- ë) prindërit e vetëm;
- f) viktimat të trafikimit /viktimat të mundshme të trafikimit;
- g) viktimat të dhunës në familje.

Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve ose i përmirësimit të kushteve deri në ndërtim të ri, janë:

- a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;
- b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

Me përmirësim të kushteve të banesave ekzistuese dhe, nëse është e nevojshme, deri në ndërtim të ri, kuptohet tërësia e punimeve që duhet të kryhen, me qëllim që banesa të shndërrohet në një strehim të përshtatshëm, sipas kushteve të parashikuara në nenin 4 të ligjit 22/2018 .

Administrimi i kërkesave dhe identifikimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të objekteve/banesave ekzistuese duhet të bëhet nga strukturat përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

2. Misioni dhe Elementet kyç

2.1. Misioni

Programe sociale strehimi janë programe që shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve që banojnë në mjedise që nuk klasifikohen si vende për banim nën normat e strehimit dhe nuk kanë mundësi ekonomike, si dhe ato familje/individë, banesa e të cilëve është nën normën ligjore të strehimit dhe që nuk kanë të ardhura që të ndërhyjnë për përmirësimin e banesave të tyre. Më specifikisht “Programi për përshtatjen e përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”, i financuar me grante nga fondet e buxhetit të shtetit, synon të mbështesë familjet në kushte të vështira ekonomike, me qëllim përmirësimin e kushteve të tyre të jetesës.

2.2 Baza ligjore

Hartimi dhe zbatimi i programeve sociale për strehim mbështetet në ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social”, (në vijim referuar si “ligji nr. 22/2018”) dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij, të cilët synojnë të përcaktojnë tërësinë e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 22/2018, aktualisht mund të aplikohen këto programe sociale strehimi:

- a) programi i banesave sociale me qira;
- b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;
- c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;
- ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;
- d) programi për krijimin e banesave të përkohshme;
- dh) programi i banesave të specializuara.

Në nenin 67, të ligjit nr. 22/2018, parashikohet shprehimisht se programet sociale të strehimit financohen nga:

a) fondet buxhetore, që jepen çdo vit për programe strehimi nga ministria përgjegjëse për strehimin;

b) fonde nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore;

c) kontribute dhe investime nga Drejtoria privat;

ç) kontributet nga donatorë të ndryshëm, vendas ose të huaj.

Në nenin 9, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, (në vijim referuar si “ligji 139/2015”), përcaktohet se njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në Kushtetutë, në ligje dhe aktet nënligjore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave mund të nxjerrin urdhëresa, vendime dhe urdhra”.

Sipas nenit 24, të ligjit nr. 139/2015, njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet e tyre në fushën e shërbimeve sociale. Njësitë e qeverisjeve vendore janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj.

Në nenin 54, të ligjit nr.139/2015, ndër të tjera, përcaktohet se është kompetencë e Këshillit Bashkiak që të miratojë normat, standardet dhe kriteret për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik.

2.3. Përkufizime

2.3.1. Për efekt të zbatimit të këtij programi, këto terma kanë kuptimin si më poshtë:

“**Familje**” do të konsiderohet njësi shoqërore e përbërë nga dy ose me shumë persona të cilët kane midis tyre lidhje martesore, gjaku ose birësimi dhe ato të kujdestarisë që jetojnë në të njëjtën strehë.

“**Individë**” do të konsiderohet një person që sipas statusit të certifikatës së gjendjes familjare në datën e aplikimit rezulton të jetë Kryefamiljar i vetëm.

“**Të ardhura familjare**” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuar, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk do të përfshihen të ardhurat që sigurohen si rezultat i orëve shtesë të punës, pasi ato janë të ndryshueshme në kohë, të ardhurat nga ndihma ekonomike, pagesat e papunësisë, përfitimet e personave me aftësi të kufizuara, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, nga ndihma ekonomike për shkak të aftësisë së kufizuar, e parashikuar në ligjin nr. 57/2019, “Për asistencën sociale”, në ligjin nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik”; nga rimbursimi i shpenzimeve për energji elektrike, nga

rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe nga paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara;

“**Banesë**” është bashkësia e mjediseve ose mjedisi i vetëm që ka hyrje të pavarur (derë) dhe dalje në rregën publike.

“**Grante Konkurruese**” janë fonde të kushtëzuara që përdoren nga ministria përgjegjëse për strehimin, për financimin e plotë ose të pjesshëm të projekteve që propozohen dhe zbatohen nga organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për qëllime të këtij ligji.

“**Kushte emergjente për strehim**” janë kushtet në të cilat ndodhen individët/ familjet që banojnë në banesa në rrezik shembjeje, në banesa që nuk plotësojnë kushtet higjieno-sanitare dhe në banesat që prishen për shkak të ndërtimeve të veprave publike, të cilat nuk përfitojnë kompensim financiar nga procedurat e shpronësimit.

“**Të ardhura mesatare**” është niveli mesatar i konsumit familjar, sipas nivelit më të ulët territorial të disagregimit të të dhënave nga INSTAT-i dhe që publikohet në mënyrë periodike. Për efekt të llogaritjes së nivelit të të ardhurave mesatare, familjet grupohen si më poshtë:

a) familje me të ardhura mesatare, që janë familjet me të ardhura mujore midis 100 dhe 120 për qind e të ardhurave mesatare;

b) familje me të ardhura të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore midis 70 dhe 100 për qind e të ardhurave mesatare;

c) familje me të ardhura shumë të ulëta, që janë familjet me të ardhura mujore më të ulëta se 70 për qind e të ardhurave mesatare;

ç) familje pa të ardhura, që janë familje me ndihmë ekonomike, si dhe ato që përveç ndihmës ekonomike përfitojnë pagesat sipas paragrafit të dytë të pikës 44, të ligjit nr. 22/2018;

“**Dokumente të vlefshme**” janë dokumentet e lëshuara nga institucionet kompetente, që përmbajnë një datë jo më të vonë se 3 (tre) muaj nga data që ato dorëzohen pranë Njësisë Administrative/Lagjeve apo Bashkisë Vau Dejës

2.4 Përfituesit potencialë dhe kohëzgjatja e programit

Nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave eksistuese, deri në një ndërtim të ri, përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm. Përparësi në trajtimin me këtë program sipas ligjit kanë:

a) personat me aftësi të kufizuara;

b) individët me statusin e jetimit;

c) familjet e policëve të rënë në detyrë;

ç) të moshuarit;

d) komuniteti rom;

dh) komuniteti egjiptian;

e) komunitetet e zonave rurale;

ë) prindërit e vetëm;

f) viktima të trafikimit /viktima të mundshme të trafikimit;

g) viktima të dhunës në familje.

2.5. Shtrirja gjeografike

Programi synon të përfshijë dhe mbështesë të gjithë individët dhe familjet që kanë vendbanim në territorin e Bashkisë Vau Dejës.

3. Zbatimi i programit

3.1.Zbatimi i programit social të strehimit “Programi për përshtatjen e përmirsimin e kushteve të banesës ekzistuese, deri në një ndërtim të ri, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit udhëhiqet nga Sektori i Shërbimit Social/ Drejtoria e Shërbimit Social ,Arsimit, Rinise dhe Sportit dhe zbatohet në bashkëpunim me strukturat dhe drejtori të tjera të Bashkisë, si më poshtë vijon:

- Njësitë Administrative;
- Koordinatori për të drejtën e informimit dhe transparencës;
- Sektori i Buxhetit dhe Finances /Drejtoria Ekonomike;
- Sektori i Investimeve dhe Projekteve Publike/Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike;
- Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe çështjeve Gjyqësore/Drejtoria Juridike e Prokurimeve edhe e Integritimit;
- Sektori i Ndhimes Ekonomike dhe PAK/Drejtoria e Shërbimit Social ,Arsimit, Rinise dhe Sportit.
- Komisioni i Strehimit
- Këshilli Bashkiak

3.2.Për zbatimin e këtij programi, strukturat përgjegjëse do të kryejnë detyrat e përshkruar në vijim:

a. Sektori i Shërbimit Social/ Drejtoria e Shërbimit Social , Arsimit, Rinise dhe Sportit:

- Harton thirrjen për aplikim;
- Realizon paraseleksionimin e formularëve të aplikimit dhe dokumentacionit që i bashkëlidhet, brenda një afati kohor prej 30 ditëve dhe vendos në dispozicion të Komisionit të Strehimit, vetëm praktikantët e sakta që përmbajnë formularët e aplikimit dhe dokumentacionin e individëve apo familjeve që kanë aplikuar për këtë program strehimi dhe që në bazë të kriterëve të vendosura kualifikohen si të vlefshëm.
- Në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit njofton të gjithë aplikuesit, që kanë dorëzuar formularin dhe rezultojnë të kualifikuar për fazën e dytë të programin të strehimit social

“Programi për përshtatjen e përmirsimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”, si dhe ato që nuk kanë përfituar, duke përcaktuar për to edhe afatin kohor brenda të cilit aplikantët jofitues mund të paraqesin ankesat e tyre pranë Kryetarit të Bashkisë apo personit të autorizuar prej tij;

- Kryen verifikimin e dokumentacionit dhe të informacionit për vazhdimin e fazës së dytë të programit social të strehimit “Programi për përshtatjen e përmirsimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri” dhe ia paraqet Komisionit të Strehimit;
- Përgatit relacionin dhe projektvendimin për miratim në Këshill Bashkiak pas raportit përmbledhës së Komisionit të Strehimit;
- I komunikon Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, listën e përfituesve të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak;

b. Koordinatori për të drejtën e informimit dhe transparencës

- Në koordinim me Sektorin e Shërbimit Social kryen të gjitha njoftimet për publikun;
- Kryen njoftimin për aplikim në përputhje me thirrjen e hartuar nga struktura përkatëse;
- Realizon shpalljen publike për aplikuesit fitues të fazës së parë për dorëzimin e pjesës tjetër të dokumentacionit sipas njoftimit të SSHS . Njofton publikisht dokumentacionin që kërkohet për verifikimin e të dhënave që deklaron subjekti i interesuar për t’u kualifikuar për programin social të strehimit “Programi për përshtatjen e përmirsimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”, i financuar nga buxheti i shtetit.
- Njofton publikun në lidhje me organin ankimor, të cilit duhet t’i drejtohet subjekti i interesuar që nuk është përzgjedhur fitues, afatet kohore, vendin që duhet të depozitohet ankimi, si edhe formatin e ankimit.

c. Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe çështjeve Gjyqësore/Drejtoria Juridike e Prokurimeve edhe e Integritit

- Në bazë të Raportit Përmbledhës të hartuar nga Komisioni i Strehimit, në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit Social harton projektvendimin për miratimin e listës së përfituesve, e cila i paraqitet për miratim Këshillit Bashkiak.
- Asiston Sektorin e Shërbimit Social në lidhje me çdo paqartësi mbi saktësinë dhe domosdoshmërinë e dokumentacionit i cili duhet të përdoret në aplikimin për projekte të programit të “Përmirësimit të banesave ekzistuese , deri në një ndërtim të ri”

d. Sektori i Ndihtes Ekonomike dhe PAK/ Drejtoria e Shërbimit Social ,Arsimit, Rinise dhe Sportit.

- Administratori shoqëror në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore kryen verifikimin e gjendjes ekonomike të familjes .

e. Sektori i Investimeve dhe Projekteve Publike/Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike;

- Pergatit dhe nxjerr;

-studimin e zonës, planin urbanistik;

-aktverifikimin që banesa është në rrezik shembjeje; neni 73, pika 2, d; ligji 22/2018 për “Strehimin Social ”

-relacionin mbi vlerësimin e kostove, eficientë dhe efektivitetin e përdorimit të grantit, kohëzgjatjen e përshtatjes, vlerësimin e riskut.

-planvendosjen e objektit, shoqëruar me distancat nga pikat kryesore të qytetit dhe shërbimet bazë;

-të dhënat teknike, si sipërfaqja e objektit, numri i apartamenteve dhe përshkrimi i llojit të ndërhyrjeve për përshtatje;

-projektin teknik të ndërhyrjes për përshtatje;

dhe dokumenta të tjera që lindin gjatë procesit të punës .

Në mungesë të çertifikatës së pronësisë, nxjerr në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për legalizimet e zonave informale, verifikojnë kushtet për legalizim dhe , nëse keto përmbushën, i paraqet ministrisë që financon programin vërtetimin mbi plotësimin e kushteve për financim .

dh. Njësitë Administrative

- Vendosin në dispozicion të punonjësit që mbulon çështjet e strehimit ambjentin pranë zyrave me një ndalesë që të asistojë qytetarëve të interesuar për strehim për të plotësuar formularin e strehimit, duke ofruar ndihmën aktive dhe asistencë për aplikuesit të plotësojnë formularin e programit duke i bashkëlidhur deklaratën e vërtetësisë së informacionit paraprak, i cili përmban një kopje të kartës së identitetit dhe certifikatën e gjendjes familjare.
- Dokumentacioni i parashikuar në pikën 16, të vendimit nr. 384, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, që mbajnë apo përgatisin organet publike në vend, sigurohet nga punonjësi që mbulon çështjet e strehimit në Njësi Administrative , duke përjashtuar aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre vetëm nëse aplikanti

depoziton deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e informacioneve/dokumenteve të lidhura me të, sipas formatit tip që i bashkëlidhet këtij vendimi, si Aneksi Ç, si dhe dokumentet e tjera që duhet të depozitohen kryesisht nga individët/familjet.

e. Komisioni i Strehimit

- Pas ezaurimit të procedurës dhe afatit të parashikuar për ankimimin, shqyrton vetëm formularët e aplikimeve dhe dokumentacionin e seleksionuar si të rregullt nga Sektori i Shërbimit Sociale dhe harton listën përfundimtare të familjeve përfituese, në bazë të kritereve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës së strehimit social.
- Në përfundim të vlerësimit, harton Raportin përmbledhës drejtuar Kryetarit të Bashkisë, në të cilin detajohen procedurat e ndjekura dhe listën e përfituesve, e cila i paraqitet për miratim Këshillit Bashkiak nga Sektori i Shërbimeve Sociale.

f. Kryetari i Bashkisë, ose personi i autorizuar prej tij

- Brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit 30 ditor të ankimit të fazës së parë, trajton ankesat e aplikuesve që nuk janë shpallur përfitues të fazës së parë të aplikimeve. Këto ankesa mund të shqyrtohen, vetëm nëse janë depozituar pranë Bashkisë Vau Dejës, në një afat prej jo më vonë se 30 ditë nga momenti i njoftimit të kryer nga struktura përkatëse (SSHS/KK) sipas ligji nr 22/2018); neni 66 , pika 3,
- “Vendimi i rivlersimit të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore mund të ankimohet në gjykatën kompetente, në përputhje me afatet dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative si dhe piken 14 te VKM-se nr 334 datë 12.06.2019 për “Përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehimin sipas cdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”
- Pas miratimit nga ana e këshillit bashkiak, te listes se perfituesve përcjell pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë listën përfundimtare për financimin e pjesshëm ose të plotë të projekteve që propozohen dhe zbatohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese, nëpërmjet procedurave të konkurimit të hapur dhe transparent.

g. Këshilli Bashkiak.

Miraton listën përfundimtare të përfituesve të programit të strehimit social “Programi për përshtatjen e përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”, i financuar nga fondet e buxhetit të shtetit.

4. Fushata / Takime informuese dhe njoftimi i thirrjes për aplikim sipas neni 73, pika 2/gj e ligjit 22/2018)

a. Një Takimet informuese një mujore do të organizohet duke pasur si objektiv thirrjen për aplikantët e pranueshëm, përfituesit potencialë të programit të strehimit “Programi për përshtatjen e përmirsimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit.

b. Fushata informuese do të bëhet pranë Njësisë Administrative, Koordinatori për të drejtën e informimit dhe transparencës, në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimit Social.

c. Njoftimi Publik hartohet nga Sektori i Shërbimit Social sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij udhëzuesi dhe duhet të përfshijë informacion për tërësinë e procesit të aplikimit, dokumentacionin e kërkuar dhe kriteret e pranueshmërisë.

d. Njoftimi i programit të “Programi për përshtatjen e përmirsimin e kushteve të banesave ekzistuese , deri në një ndërtim të ri”, publikohet online në faqet e internetit të Bashkisë. Njoftimi Publik të jetë në dispozicion në kopje të printuara në zyrat e pritjes së qytetarëve pranë Bashkisë së Vau Dejës dhe njësitë administrative.

e. Të gjitha publikimet, njoftimet dhe materialet e tjera do të ofrojnë informacion për aplikantët e interesuar mbi afatet e dorëzimit dhe procesin e përzgjedhjes do të gjenden pranë Zyrave të Pritjes me Qytetarët pranë Bashkisë së Vau Dejës dhe pranë Njësisë Administrative.

5. Faza e parë e aplikimit,

5.1. Individët që kanë mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, kujdestarët ligjorë për rastet e personave të vendosur në kujdestari ligjore, për shkak të heqjes apo kufizimit të zotësisë për të vepruar dhe familjet që janë të regjistruara në zyrat e gjendjes civile të Bashkisë Vau Dejës, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2, 3 e 4, të nenit 13, të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë për të përfituar nga programi “Programi për përshtatjen e përmirsimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim t ri”, i financuar me fondet e buxhetit të shtetit.

5.2. Aplikantët brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i publikimit të thirrjes duhet të plotësojnë Formularin e strehimit TIP (Shtojca A), pranë speciaistit të sektorit të shërbimit social që mbulon çështjet e strehimit, të cilit do t’i bashkëlidhin edhe dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratën e vërtetësisë së informacionit paraprak të pasqyruar në formularin e strehimit, me anë të së cilës aplikuesit i bëhen të njohura edhe përgjegjësitë ligjore që ai ka në lidhje me dhënien e një informacioni dhe fakteve të rreme, sipas (shtojca B) , pjesë përbërëse e këtij udhëzuesi;

- Kopjen e kartës së identitetit të aplikuesit.
- Certifikatën familjare
- 4 fotografi të banesës ekzistuese

5.3. Pas plotësimit të formularit dhe dokumentacionit si më lart, specialisti që mbulon çështjet e strehimit në Njësiti Administrative pasi ben rregjistrimin e kërkeses (Shtojca C) dhe i protokollon të nënshkruar nga vete punonjësi dhe qytetari aplikues. Sektori i i Shërbimit Social, realizon procesin e seleksionimit të formularëve të vlefshëm sipas pikës 8 e VKM-se nr 384 dt 12.06.2019, si më poshtë :

- a) Identitetin, emrin, atësinë, mbiemrin;
 - b) Numrin e kërkesës;
 - c) Datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;
 - ç) Objektivin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e strehimit social;
 - d) Numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës; dh) Adresën e kërkuesit;
 - e) Përbërjen familjare në momentin e aplikimit;
 - ë) Statusin e punësimit;
 - f) Kushtin social, sipas nënndarjeve “i” derinë “xv”, të shkronjës “c”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018;
- i. personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave;
 - ii. individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;
 - iii. familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimittëbanesaveish-pronarëve;
 - iv. emigrantët e rikthyer, punëtorë të migrantëve dhe azilkërkuesit;
 - v. familjet e policëve të rënë në detyrë;
 - vi. punonjësit e reparteve të ndërhyrjes së shpejtë (FNSH);
 - vii. punonjësit e repartit RENE A;
 - viii. punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
 - ix. viktimat e dhunës në familje;
 - x. viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit;
 - xi. anëtarët e komunitetit rom;
 - xii. anëtarë të komunitetit egjiptian;
 - xiii. të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;
 - xiv. vajzat nëna;

xv. individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimë për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individit nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të Ligjit nr 22/2018 “ Për strehimin”.

g) Kushtin e strehimit, shkronja “a”, tënenit 16, tëligjit nr. 22/2018, si mëposhtë:

gj) Kushtin familjar, sipas nënndarjeve “i” deri në “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018;

- i. familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
- ii. të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk për zgjidhen për t’u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;
- iii. familjet me më shumë se katër fëmijë;
- iv. bashkëshortët, moshë e përgjithshme e përbashkët e të cilëve arrin deri në 60 vjeç.

h) Kushtin ekonomik, ku evidentohen të ardhurat mujore të familjes, sipas përcaktimit të pikës 44, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018... *“Të ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuar, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme...*

5.4. Në qofte se kërkesa e aplikantit ka të meta dhe mangësi të të dhënave të kërkuara nga ky vendim , struktura përgjegjëse për strehim brenda 7 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës i kërkon me shkrim aplikantit të korrigjojë pasaktësitë duke përcaktuar edhe afatin e nevojshëm për plotësimin e tyre, kur kërkuuesi nuk plotëson pasaktësitë brenda afatit të caktuar kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet aplikantit, pika 9 e VKM-se nr 384 dt 12.06.2019.

5.5. Çdo invidivi familje që paraqet kërkesën në çdo rast i lëshohet një vertetim që konfirmon regjistrimin e kërkesës , objektin e saj, datën dhe listën e dokumentave bashkëlidhur nëse ka të tillë sipas formatit që i bashkëlidhet këtij vendimi (Shtojca C), pika 10 e VKM-se nr 384 dt 12.06.2019.

5.6. Strukturat përgjegjëse për strehimin ose zyra e shërbimit me një ndalesë ofron ndihmë aktive për plotësimin e formularëve të aplikimit për përfitimin nga programet e strehimit social për cilindo aplikues, duke u kujdesur veçanërisht për individët me aftësi të kufizuar në të parë e në të folur nëpërmjet interpretuesit të gjuhës së shenjave ose lehtësuesit të komunikimit, të moshuarit, personat që nuk kuptojnë gjuhën shqipe ose ata që nuk dinë shkrim e këndim, si dhe siguron që çdo individ/familje që ka vështirësi komunikimi, për

shkak të gjendjes shëndetësore ose sociale, të marrë informacionin e ndihmën e nevojshme për këtë qëllim.

6. Faza e dytë e aplikimit:

6.1.Klasifikimi i kërkesave për strehim sipas sistemit të pikëzimit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak. Sektorii i Shërbimit Social, realizon procesin e seleksionimit të formularëve të vlefshëm sipas pikës 8 të VKM-se nr 384 dt 12.06.2019

6.2.Dorëzimi i dokumentacionit. Njoftim i subjekteve të përzgjedhur për t'u trajtuar me një nga programet e strehimit për plotësimin e dokumentacionit sipas përcaktimeve ligjore; Sektoi i Shërbimit Social, në bashkëpunim me Koordinatorin për të drejtën e informimit dhe transparencës, shpallin njoftimin për dorëzimin e dokumentacionit që duhet të dorëzojnë individët apo familjet që kanë kaluar fazën e parë të aplikimit. Individët apo familjet që kanë kaluar fazën e parë, kanë 30 ditë kohë për të dorëzuar dokumentacionin e parashikuar në ligj. Familjet përfituese pas marrjes së njoftimit nga Sektori i Shërbimit Social, paraqesin, pranë specialistit që mbulon çështjet e strehimit në Njesisë Administrative, të gjithë dokumentacionin sipas (Shtojca D) bashkëlidhur këtij udhëzuesi dhe pjesë përbërëse e tij. Dokumentacioni mbështetet në deklaratimet e bëra dhe që aprovon vërtetësinë e aplikimit të bërë në momentin e dorëzimit të formularit të strehimit pranë specialistit që mbulon çështjet e strehimit Njesisë Administrative përkatëse ku ato janë. Dokumentacioni i parashikuar në VKM 384/2019 pika 16 në shkronjën “ç”, nënndarjet “vii”, “ix” e “x”, si dhe në nënndarjen “i”, të shkronjës “d”, të pikës 16, të këtij vendimi, dorëzohet nga vetë aplikanti, me përjashtim të rasteve kur sigurimi i tyre është i pamundur për shkak të situatave të dhunës në familje, e vërtetuar me urdhër mbrojtjeje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata.

Struktura përgjegjëse mbledh cilindo prej dokumenteve të nevojshme, duke përjashtuar aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre , nëse aplikanti depoziton deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e informacioneve/dokumenteve. Pas marrjes së njoftimit, individët/familjet përfituese të fazës së parë depozitojnë pranë specialistit që mbulon çështjet e strehimit në Njesisë Administrative deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e informacioneve/dokumenteve të lidhura me të, sipas formatit tip që i bashkëlidhet këtij vendimi, si (Shtojca Ç).

Specialisti në bashkëpunim me Njësia Administrative dhe zyrat përkatëse të Bashkisë plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, duke përfshirë edhe dokumentacionin që sipas akteve në fuqi duhet të depozitohen kryesisht nga aplikanti dhe i protokollon ato me njëlistë inventari sipas (Shtojca D)për secilin aplikues .

Në të kundërt, nëse aplikanti/familjet nuk dorëzojnë apo refuzojnë të firmosin deklaratën e parashikuar, specialisti që mbulon çështjet e strehimit në Njesisë Administrative/ shkarkohen nga detyrimi i mbledhjes së dokumentacionit dhe ky detyrim i kalon vetë aplikantit. Në këtë

rast, individët do të dorëzojnë pranë specialistit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton deklarin dhe vërtetësinë e plotësimit të formularit të strehimit në bazë të të cilit janë përzgjedhur fitues.

Çdo formulari i bashkëlidhet edhe lista e inventarit (bashkëlidhur këtij udhëzuesi) i cili përmban të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit dhe i nënshkruar nga punonjësit e autorizuar të Shërbimeve Sociale (Shtojca D).

6.3 Shqyrtim dhe verifikim i dokumentacionit. Struktura përgjegjëse në Bashki klasifikon kërkesat sipas sistemit të pikëzimit të mitatuar dhe realizon shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga çdo aplikant dhe në vijim dërgon për vlerësim dhe shqyrtim të mëtejshëm pranë Komisionit të strehimit. (Brenda 10 diteve nga data e dorëzimit) Sektori i Shërbimit Social vendos në dispozicion të Komisionit të Strehimit vetëm praktikantët e sakta që përmbajnë formularët e seleksionuar si të vlefshëm gjatë Fazës së parë të shqyrtimit, si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesit. Për çdo aplikim, të refuzuar apo të pranuar gjatë fazës së dytë, Sektori i Shërbimit Social përgatit një informacion të shkurtër (Shtojca DH).

6.4 Pas marrjes në dorëzim, të listës së inventarit, Komisioni i Strehimit, në bazë të dokumenteve të dërguara nga aplikuesit, kriterëve për përzgjedhjen e përfituesve dhe formulës së pikëzuar, shqyrton dhe vlerëson aplikimet, duke vendosur pikët për secilin aplikim.

6.5 Dërgimi për miratimin e listës përfituese në Këshillin Bashkiak . Pas vlerësimit nga Komisioni i vlerësimit, struktura përgjegjëse në Bashki dërgon për miratim në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, Listën e përfituesve për secilin program të strehimit social që zbaton.

6.6 Njoftimi dhe e drejta e ankimimit. Çdo aplikues që nuk ka përmbushur kriteret për të qenë pjesë e listës përfituese, njoftohet nga struktura përgjegjëse e Bashkisë dhe mund të paraqesin ankim pranë kryetarit të bashkisë, por kjo nuk pengon ushtrimin e mjetit ligjor mbrojtjes pranë gjykatës kompetente.

- Familjet që nuk kanë përfituar, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, kanë të drejtën e ankimimit pranë Bashkisë Vau Dejës.
- Kryetari i Bashkisë, ose personi i autorizuar prej tij, brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit 30 ditor për ankimimin, trajton ankesat e paraqitura dhe njofton aplikuesin në lidhje me vendimin e marrë për ankimin e paraqitur.

6.7 Aplikantët mund të refuzojnë programin e strehimit dhe të mbeten përseri në listën e pritjes, vetëm kur nuk u plotësohet strehimi sipas normave në fuqi.

7. Kriteret për përzgjedhjen e përfituesve – Formula e Pikëzuar

7.1. Vlerësimi i aplikimeve të paraseleksionuara dhe dokumentacionit shoqërues do të kryhet nga Komisioni i Strehimit mbi bazën e një sistemi të pikëzimit, që do të hartohet nga ky komision në bazë të shpërndarjes së totalit të 100 pikeve, sipas kritereve dhe kushteve të strehimit, familjare, sociale, ekonomike. Pas hartimit, sistemi i pikëzimit do të miratohet në Këshillin e Bashkisë Vau Dejës.

7.2. Komisioni i Strehimit, në bazë të listës së inventarit të përcjellë dhe nënshkruar nga Sektori i Shërbimit Social, shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin, dhe referuar këtij sistemi pikëzimit, vendos pikët për secilin aplikim.

8. Hartimi i Raportit përmbledhës dhe dërgimi në Këshill Bashkiak.

a. Procesi i përzgjedhjes finalizohet me zbardhjen e procesverbalit përkatës (Shtojca E), ku përfshihet edhe lista përfundimtare të aplikantëve dhe përfituesve. Komisioni i Strehimit, i paraqet Sektori i Shërbimit Social, procesverbalin së bashku me listën e përfundimtare të përfituesve.

b. Njëkohësisht, Komisioni i Strehimit harton dhe një Raport Përmbledhës, i cili i bashkëlidhet materialit që i përcillet Këshillit Bashkiak për miratimin e listës përfundimtare.

9. Miratimi i listave përfundimtare në Këshillin Bashkiak

a. Mbi bazën e Raportit Përmbledhës, Sektori i Shërbimit Social në bashkëpunim me Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore/Drejtoria Juridike e Prokurimeve edhe e Integritetit ndjekin procesin e listës përfundimtare të përfituesve dhe projektvendimit për miratimin e saj në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak sipas afateve ligjore të përcaktuara.

b. Pas miratimit të listës përfundimtare nga Këshilli Bashkiak (Shtojca F), ajo shpallet në stendën e buletineve për publikun, faqen e internetit të Bashkisë, dhe vende të tjera publike. Një kopje e saj i dërgohet zyrtarisht Sektorit të Shërbimit Social, e cila e pasqyron tek ministria e linjës për aplikimet për projektet për programin e “Përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri”

Përfitojnë nga ky program familjet që plotësojnë kushtet sipas nenit 41, sipas nenit 43 të ligjit 22/2018, “Për strehimin social”, të cilat, në kohën e paraqitjes së kërkesës pranë strukturave të Bashkisë Vau Dejës:

a) objektet/banesatnërrezikshembjeje;

b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

c) rregullimin e banesave individuale ose strukturave, të cilat klasifikohen si banesë nën normen e strehimit dhe vetë familjet nuk sigurojnë të ardhurat e nevojshme për ta kryer vetë përmirësimin.

Sqarim!

Niveli i të ardhurave të familjeve bazohet në të dhënat e përditësuara mbi nivelin mesatar të konsumit për Bashkinë Vau Dejës, sipas strukturave të familjeve të përcaktuara nga **INSTAT për vitin 2017**.

(Aneks 1)

NJOFTIM

Kushtet, procedurat dhe dokumentacioni për të përfituar nga programet e strehimit social

_____/_____/2020

Bazuar në ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”; VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

Bashkia Vau Dejës fton të gjithë qytetarët e interesuar, që kanë nevojë për strehim, që të aplikojnë për të përfituar nga programi i strehimit social “ *Përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri*”

Kushtet për të përfituar nga programet e strehimit që do të zbatohen në Bashkinë Vau Dejës: “ Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese deri në një ndërtim të ri”

Me përmirësim të kushteve të banesave ekzistuese dhe , nëse është e nevojshme , deri në ndërtim të ri, kuptohet tërësia e punimeve që duhen të kryhen, me qëllim që banesa të shndërrohet në një strehim të përshtatshëm, sipas neni 4 të Ligjit nr 22/2018 “ Për strehimin social”

- Të jetë banor i Bashkisë Vau Dejës;
- Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;
- Shtetas të huaj me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si “punëtor emigrant” dhe/ose “azilkërkues”
- Vetëm individët/familjet që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë të ardhura fare sipas përcaktimeve të nenit 3 të Ligjit nr 22/2018.
 - ❖ Objektet dhe banesat , që trajtohen nga program i përmirësimit të kushteve ose i përmirësimit të kushteve deri në ndërtim të ri , janë :
- Objektet/ banesat në rrezik shembjeje;
- Objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme .
- Rregullimin e banesave individuale ose strukturave, të cilat nuk klasifikohen si banese nga vetë familjet që nuk sigurojnë të ardhurat e nevojshme për ta kryer vetë përmirësimin.

Procedurat për të përfituar nga programet sociale të strehimit.

Faza parë:

1. **Plotësimi i formularit tip pranë Zyrës me një Ndalesë në Bashki(Kërkese).** Çdo qytetar i cili përmbush kriteret për aplikim sipas akteve ligjore në fuqi duhet të drejtohet pranë zyrës me një ndalesë për të plotësuar formularin e aplikimit.
2. Aplikanti duhet të paraqitet me kopje të mjetit të identifikimit.
3. Deklaratën e vërtetësisë së informacionit paraprak të pasqyruar në formularin e strehimit, me anë të së cilës aplikuesit i bëhen të njohura edhe përgjegjësitë ligjore që ai ka në lidhje me dhënien e një informacioni dhe fakteve të rreme.
4. Certifikatën familjare
5. Kater(4) fotografi të banesës ekzistuese
6. Në rast se kërkesa e aplikantit ka të meta dhe mangësi të të dhënave të kërkuara , i kërkohet me shkrim aplikantit brenda 7 ditëve të korrigjojë pasaktësitë
7. Cdo individ i lëshohet një vërtetim që konfirmon regjistrimin e kërkesës.

Faza dytë:

- 7 **Klasifikimi i kërkesave për strehim sipas sistemit të pikëzimit të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak.**
- 8 **Dorëzimi i dokumentacionit.** Njoftim i subjekteve të përzgjedhur për t`u trajtuar me një nga programet e strehimit për plotësimin e dokumentacionit sipas përcaktimeve ligjore;
- 9 Struktura përgjegjëse mbledh cilindo prej dokumenteve të nevojshme, duke përjashtuar aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre , nëse aplikanti depoziton deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e informacioneve/dokumenteve.

- 10 **Shqyrtim dhe verifikim i dokumentacionit.** Struktura përgjegjëse në Bashki klasifikon kërkesat sipas sistemit të pikëzimit të mitatuar dhe realizon shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga çdo aplikant dhe në vijim dërgon për vlerësim dhe shqyrtim të mëtejshëm pranë Komisionit të strehimit. (Brenda 10 diteve nga data e dorëzimit)
- 11 **Dërgimi për miratimin e listës përfituese në Këshillin Bashkiak .** Pas vlerësimit nga Komisioni i vlerësimit, struktura përgjegjëse në Bashki dërgon për miratim në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, Listën e përfituesve për secilin program të strehimit social që zbaton.
- 12 **Njoftimi dhe e drejta e ankimit.** Çdo aplikues që nuk ka përmbushur kriteret për të qenë pjesë e listës përfituese, njoftohet nga struktura përgjegjëse e Bashkisë dhe mund të paraqesin ankim pranë kryetarit të bashkisë, por kjo nuk pengon ushtrimin e mjetit ligjor mbrojtjes pranë gjykatës kompetente.
- 13 **Aplikantet** mund të refuzojnë programin e strehimit dhe të mbeten përseri në listën e pritjes, vetëm kur nuk u plotësohet strehimi sipas normave në fuqi.

Lista e dokumentacionit të nevojshëm:

Për të dhënat personale:

- Çertifikata e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë levizur nga zona të tjera të vendit.

Për vërtetimin e kushteve të strehimit:

- Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës se nuk figuron e rregjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- Vërtetimin që banesa është në proces legalizimi , në mungesë të certifikatës së pronësisë.
- Akt verifikimi nga Bashkia për:
- Banesat në rrezik shembjeje.
- Akt verifikimi nga struktura përgjegjëse e bashkisë për familjet rome/egjiptjane që banojnë në banesa individuale ose struktura, që nuk klasifikohen si banesë;

Për vërtetimin e kushteve familjare:

- Çertifikatë familjare (shkarkohet në E-Albania);

- Vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara, shoqëruar me vërtetimin nga zyra e përmbarimit për masën e pensionit që përfitojnë për fëmijët;

Për vërtetimin e kushteve sociale:

- Vërtetimin e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara,
- Vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
- Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”:

Emigrant dhe punëtor emigrant

- Vërtetim nga sportelet e migracionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Cështjeve sociale.
- Vërtetim nga Zyra e shërbimit Kombëtar ose Vërtetim i marrë pranës Zyrës së Punës

Azilkërkues:

- Vërtetim nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme.

- Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Cështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të armatosura, të Shërbimit informative, të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve:

- Vërtetim nga Policia e Shtetit;
- Vërtetim nga Garda e Republikës;
- Vërtetim nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm;
- Vërtetim nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;
- Vërtetim nga Forcat e Armatosura;

- Urdhër mbrojtje apo urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje.
- Vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare romë apo egjiptjane;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- Vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
- Vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë- nënë.

Për vërtetimin e kushteve ekonomike:

- Vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumente zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe e Sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve për të gjithë anëtarët e e vetëpunësuar të familjes (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetimin nga zyra e ndihmës ekonomike e bashkisë për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar (sigurohet nga Bashkia);
- Vërtetimin nga drejtoria rajonale e punësimit për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension (shkarkohet në E-Albania);

Dokumentacioni i parashikuar sigurohet nga struktura përgjegjëse për strehim vetëm nëse aplikanti depoziton deklaratën e pëlqimit sipas formatit tip, shtojca "Ç", që plotësohet bashkë me Formularin e Aplikimit pranë Zyrës me një Ndalesë.

Aplikimet janë të hapura nga data 01.10.2020 deri me datën 01.11.2020

Specialisti që mbulon çështjet e strehimit në periudhën e hapjes së aplikimeve do të jetë prezent për të marrë aplikimet si më poshtë ;

Diten e Henë në Njësinë Administrative Hajmel 08:00-16:00

Diten e Marte dhe të Merkurë në Bashkinë Vau Dejës 08:00-16:00

Diten e Enjte dhe Premte në Njësinë Administrative Bushat 08:00-16:00

Aplikimet për banoret e zonësse Temal dhe Vig Mnel banoret mund ti bejnë në Bashki, ndërsa banoret e Shllakut ne Njësinë Administrative Bushat .

ZV/KRYETAR,

Enxhela Shimoj

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Andreas Çelepi



SHTOJCA "B"

DEKLARATË E VËRTETËSISË SË INFORMACIONIT PARAPRAK

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj sa më poshtë:

1. I gjithë informacioni i dhënë në formularin KËRKESË PËR TRAJTIM ME STREHIM është i vërtetë.
2. Pranoj që, në rast se përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, të bëhet inspektimi në banesën ku banoj dhe verifikimi i të gjithë informacionit të dhënë.
3. Jam në dijeni se, për çdo informacion të rremë, mua dhe anëtarëve të familjes sime u hiqet e drejta për të përfituar strehim.
4. Jam në dijeni se, nëse përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, struktura përgjegjëse për strehimin në bashki, bazuar në të dhënat mbi të ardhurat familjare, mund të më ofrojë një formë tjetër strehimi nga ajo që kam kërkuar në KREUN IV të këtij formulari.

Nënshkruar në _____, më _____

Deklaruesi:

(Emër/Mbiemër/Firm

ë)



(Shtojca C)

VËRTETIM QË KONFIRMON REGJISTRIMIN E KËRKESËS, OBJEKTIN E SAJ,
DATËN DHE LISTËN E DOKUMENTEVE TË BASHKËLIDHURA

Vërtetimregjistrimikërkese

(NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE)

Nr. _____ Prot. _____, më ____/____/201....

Lënda: Vërtetimregjistrimikërkese përfitimnngaprogramet e strehimit social

Drejtuar: Z./Znj. _____
(adresa)

I nderuar Z./Znj. _____,

Vërtetojmë se jukeniparaqiturkërkësën me nr. _____ protokoli, datë _____, e cila ështëregjistruarpatë meta pranë _____ (njësia e vetëqeverisjesvendore), me anë tësëcilësparaqisnipreferencëntuajpërfitimnngaprogrami _____ i strehimit social.

Kërkesa juajështëregjistruar me nr. _____ nëregjistrinelektroniktësistemittëpikëzimit.
Bashkëlidhurkësajkërkesejanëdepozituaredhedokumentet, si mëvijon:

	Titulli idokumentit	Nr. ifaqeve

Duke jufalënderuar përbashkëpunimin,

(emri i punonjësit, firma)

SHTOJCA "Ç"

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR LEJEN PËR MARRJEN E DOKUMENTACIONIT PËR FAZËN E DYTË TË APLIKIMIT

DEKLARATË

PËR
DHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE, AKSESIN PËR
NJOHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Unë _____, i biri i/e bija e _____ dhe i/e _____,
lindurmë _____, në _____, dhebanues/banuesenë
_____, me shtetësi _____, me numër
identifikimi _____, me vullnetintimtë lirë,

DEKLAROJ SE:

Mbështetur dhenë zbatim të:

Pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, "Për
përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të
strehimit, dhe të afatëve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes
vendore";
pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social";
tëneneve 2, 5 e 10, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave
personale",

	Deklarimi	Firma (në kutinë që aplikanti dëshiron të plotësojë)
1.	<p>- Jap pëlqimin që të mblihdhenat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave.</p> <p>- Jap pëlqimin që të mblihdhenat dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</p> <p>- Jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura në referim të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesësime për të përfituar strehim sipas programeve social të strehimit të parashikuara në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social".</p>	
2.	<p>- Nuk jap pëlqimin që të mblihdhenat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave;</p> <p>- Nuk jap pëlqimin që të mblihdhenat dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</p> <p>- Nuk jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura, në referim të pikës 16, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesësime për të përfituar strehim sipas programeve sociale të strehimit të parashikuara në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social".</p>	

_____, më _____. _____. 20__

(Shtojca D)
LISTË INVENTARI

Nr. _____

Datë: ____ / ____ 2020

Listë inventari për aplikuesin Z/Znj _____, përfitues i fazës së parë të aplikimit, për përfitimin nga programi “Programi për përshtatjen e përmirsimin e kushteve të objekteve dhe banesave”, i financuar nga buxheti i shtetit.

Numri Rendor	Lloji i dokumentit të dorëzuar	Data e lëshimit nga institucioni përkatës	Numri i referencës së dokumentit	Komente lidhur me dokumentin
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				

Seleksionimi paraprak i dokumentacionit të aplikuesit:

Dokumentacion i plotë	Dokumentacion i paplotë	Komente

Z/Znj.
Nënshkrimi

Z/Znj.
Nënshkrimi

(Shtojca E)

Procesverbali i Vlerësimit të Aplikimit

**Procesverbal
Komisioni i Strehimit**

Procesverbal i mbajtur sot në datë ____/____/2020 në prani të antarëve.

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____
- 4 _____

të pranishëm nga

- 1 _____
- 2 _____
- 3 _____
- 4 _____

të njoftuar nëpërmjet shkresës me nr. Prot..... datë me lëndë “ Për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar për aplikimin në Programin Social të Strehimit “Për përmiresimin e kushteve tëbanesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri ”, pranë Bashkisë së Vau Dejës. .

U morën në shqyrtim aplikime, nga të cilat, rezultuan:

1. Aplikime me dokumentacion të rregullt _____
2. Aplikime me mungesë në dokumentacion _____
3. Aplikime të cilat kanë të ardhura mbi nivelin e përcaktuar të të ardhurave _____
4. Aplikime të cilat kanë të ardhura nën nivelin e përcaktuar të të ardhurave _____

Komisioni i Strehimit pasi vlerësoi të gjitha dosjet i kalon Kryetarit të Bashkisë të propozoj për miratim në Këshillin Bashkiak listën me përfituesit e Programit Social të Strehimit “Për përmiresimin e kushteve tëbanesave ekzistuese, deri ne një ndërtim të ri ”, si më poshtë vijon:

1.
2.
3.
4. etj.

(Shtojca F)

Formati i listës emërore e miratuar nga Keshilli Bashkiak

Nr. Rendor	Emri/Atësia/Mbiemri	Përbërja familjare	Struktura e banesës atit që përfiton	Kushte të strehimit (neni 16, germa (a))	Kushtet familjare (neni 16, germa (b))	Kushtet sociale (neni 16, germa (c))	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Vlera maksimale e apartamentit që përfiton
1	2	3	4	5	6	7	8	9	9

Shënim:

- .Lista emërore duhet të jetë e shtypur (jo e shkruar me shkrim dore);
- .Çdo faqe e listës emërore duhet të ketë vulën e Këshillit Bashkiak;**
- .. Kopje e shkresës përcjellëse, i dërgohet edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- .Në kolonën 2, vihet emri i kryefamiljarit/personit që aplikon;
- .Në kolonën 3, përbërja e familjes sipas çertifikatës së gjendjes familjare;
- .Në kolonën 4, struktura banesës;
- .Në kolonat 5, 6 e 7 vendoset një nga rastet e parashikuara në nenin 16, germat (a), (b) e (c) të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”;
- .Në kolonën 8, vendosen vlerat sipas tabelës nr.2 për shumën e kredisë që përfiton individi/familja;
- .Në kolonën 9, vendosen statusi i punësimit të kryefamiljarit/aplikantit:
 - .e/i punësuar në shtet;
 - .e/i punësuar në privat;
 - .i vetëpunësuar;

(Shtojca DH)
LISTË INVENTARI

Nr. _____

Datë: ____ / ____ /2020

Listë inventari për aplikuesin Z/Znj _____, përfitues i fazës së parë të aplikimit, për përfitimin nga programi “Programi për përshtatjen e përmirsimin e kushteve të objekteve dhe banesave”, i financuar nga buxheti i shtetit.

Numri Rendor	Lloji i dokumentit të dorëzuar	Data e lëshimit nga institucioni përkatës	Numri i referencës së dokumentit	Komente lidhur me dokumentin
1.				
2.				
3.				
4.				
5.				
6.				
7.				
8.				
9.				
10.				
11.				
12.				
13.				
14.				